



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurën e përgjithëshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-193 datë 17.5.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-193 datë 31.5.2023, dhe sipas Konkluzionit, ark.nr.02-2270/2 datë 5.6.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 18-të mbajtur më 1.6.2023, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqje
të lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e niciuar për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) JON-RADIO SHPK Strugë, nr.08-234 datë 30.4.2019.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 15-të mbajtur më 18.5.2023., me Konkluzionin, ark.nr.02-2106/5 datë 19.5.2023., miratoi propozimin e drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-193 datë 17.05.2023. dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, nr.08-234 datë 30.4.2019, për faktin se pas mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-2107/1 datë 16.5.2023., është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së lëshuar nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar tarifën vjetore për leje për transmetim në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë më datë 19.5.2023. drejtuar transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1.nr.08-193 datë 19.5.2023., për njoftim se nëse nuk paguan tarifën vjetore për lejen për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 31.5.2023 drejtuar drejtorit të Agjencisë, nga Sektori i Financave dhe Logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-2107/2 datë 31.5.2023, që SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, më 31.5.2023 ka kryer pagesë në shumën prej 530.477,00 (pesëqind e tridhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) denarë, me të cilën transmetuesi e ka paguar plotësisht tarifën vjetore për lejen për transmetim në radio.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të Ligji për Shërbime Mediatike

Up1 Nr.08-193

Скопје 05.06.2023



Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АГЕНЦИЈА ЗА АУДИО И АУДИОВИЗУЕЛНИ МЕДИУМСКИ УСЛУГИ

Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-193 datë 17.5.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-193 datë 31.5.2023, dhe sipas Konkluzionit ark.nr.02-2270/2 datë 5.6.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 18-të mbajtur më 1.6.2023, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetar i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimet të aktvendimit.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shiko: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësismin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).